

NJOFTIM PARAPRAK

për shpallje të Thirrjes publike 01/2013 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga komponenti i pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD Programi 2007-2013)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik **se në gjysmën e dytë të muajit qershor 2013** do të shpallet Thirrja publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga komponenti i pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2007-2013).

Qëllimi i IPARD Programit 2007-2013 është përmes masave përkatëse për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektori bujqësor-ushqimor, përmes përputhshmërisë së tyre me standardet e Unionit Evropian dhe arritja e mjedisit jetësor të qëndruar dhe zhvillimi socio-ekonomik të mjediseve rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjen e mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2007-2013 në lidhje me zbatimin e Thirrjes publike nga muaji qershor 2013 dedikohen për masat në vijim:

Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Unionit Evropian.

Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit Evropian.

Masa 302 – Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale.

Thirrja paraprake publike e IPARD programit mundëson mundësi të rritura në lidhje me llojin e investimeve, vëllim më të madh të shfrytëzuesve potencial, mundësi për furnizim të mekanizmit të ndryshëm bujqësor (duke përfshirë edhe traktorë), si dhe limite të rritura financiare për shfrytëzuesit përfundimtar të mbështetjes financiare.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2007-2013 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në bazë të arritjes së kushteve të kontraktuara. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Unioni Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programi 2007-2013 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga komponenti i pestë Instrumentit për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Unionit Evropian.

Shpallja do të zgjasë **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në shtypin ditorë.

Vërejtje: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve që do të jenë të përkrahura, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, lartësia e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Telefoni: 02 3097-460

Faks: 02 3097-454

e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave

Trupi për udhëheqje me IPARD

Telefoni: 02 3134-477

lok: 114, 115 dhe 116

e-mail adresa: info@ipard.gov.mk

www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi

Telefoni: 047 228-330

Faks: 047 228-370

www.agencija.gov.mk

Çdo ditë pune prej ora 8:30 h deri 16:30 h.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, të interesuarit prodhues bujqësorë falas mund t'i marrin në qendrat regionale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regionale dhe personave kompetentë është e shpallur në ueb faqen e institucioneve kompetente).